



Prishtinë, 28 shkurt 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1109\_2019

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

##### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/-084),
- Nenin 16 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja,
- Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V\_754\_2016 të datës 28 janar 2016 për shoqërinë "Hidroenergji" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Lepenci 1 me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, Lokacioni "Uji i Thartë" ZK Pustenic, komuna e Hanit të Elezit, dhe
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizim Final V\_754\_2016 i datës 28 janar 2016 edhe për 1 (një) vit, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Lepenci 1 me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, ZK Pustenic, komuna e Hanit të Elezit, të datë 21.01.2019 nr. prot. 555/19 të shoqërisë "Hidroenergji" SH.P.K., me adresë rruga "Dëshmorët e Kombit" pn,- Ferizaj, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 28 shkurt 2019 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Hidroenergji" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit Final V\_754\_2016 i datës 28 janar 2016, i vazhduar me vendimin V\_931\_2018 të datës 29 mars 2018 për vazhdimin e ndërtimit të Hidrocentralit HC Lepenci 1 me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, Lokacioni "Uji i Thartë", ZK Pustenic, komuna e Hanit të Elezit, edhe për 1 (një) vit, gjegjësisht deri me **28 janar 2020 për ndërtimin e Hidrocentralit.**

## A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 03.06.2013 nga shoqëria "Hidroenergji" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në Lumin Lepenc, HC Lepenci 1, me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, në Lokacionin "Uji i Thartë", Komuna e Hanit të Elezit, Republika e Kosovës.
- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmive të prezantuara nga shoqëria "Hidroenergji" SH.P.K., ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar me datë 06 shtator 2013 Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_557\_2013. Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.





- ZRRE me datë 15.07.2015 nga shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lumin Lepenc për HC Lepenci 1 me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, në lokacionin “Uji i Thartë” ZK Pustenic, Komuna e Hanit të Elezit, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen Ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 28.01.2016 ka vendosur që shoqërisë “Hidroenergji” SH.P.K., ti lëshohet Autorizimi Final V\_754\_2016 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lumin Lepenc, për HC Lepenci 1 me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, Lokacioni ZK Pustenic Komuna e Kaçanikut.
- ZRRE me datë 28.12.2017 nga shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_754\_2016 të datës 28 janar 2016, për HC Lepenci 1 me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, **për vazhdimin e ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 28 janar 2019.**
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 mars 2018, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmimeve relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë “Hidroenergji” SH.P.K., dhe me vendimin V\_931\_2018 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të vendimit për Autorizimin Final V\_754\_2016 të datës 28 janar 2016 edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 28 janar 2019, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e Autorizimit.
- ZRRE me datë 21.01.2019 nga shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka pranuar kërkesë për vazhdim të afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_754\_2016 të datës 28 janar 2016, i vazhduar me Vendimin V\_931\_2018 të datës 29 mars 2018, për HC Lepenci 1 me kapacitet të instaluar prej 9.998 MW, për një afat shtesë për zgjatjen e periudhës së ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 28 janar 2020.
- Shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., në kërkesë e saj ka sqaruar se: *pas pranimit të vendimit për autorizimin final menjëherë kanë filluar me përgatitjet e fillimit të punimeve në ndërtimin e Hidrocentralit HC Lepenci 1, duke filluar me matjet gjeodezike nga expert të fushës, janë bërë përgatitjet për hajen e rrugës, trasesë së tubacionit dhe ndërtesës së Hidrocentralit. Ka sqarua se, edhe përkundër vullnetit për finalizimin sa më të shpejt të projektit në ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese është detyruar që ti drejtohet ZRRE-së, për mundësin e shtyrjes së vlefshmërisë së Autorizimit Final për HC Lepenci 1, edhe për një vit për mundësin e finalizimit të projektit.*
- Në kërkesën e saj ka sqaruar se edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për realizimin e projektit në ndërtimin e hidrocentralit, përsëri është detyruar ti ndërpres punimet, siç iu keni informuar edhe në kërkesën paraprake, pasi që Qeveria e Republikës së Kosovës gjegjësisht Ministria e Infrastrukturës gjatë vitit 2016 ka iniciuar fillimin e projektit për ndërtimin e projektit Nacional ndërtimin e Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, të cilin projekt tani më është duke e ekzekutuar konzorciumi Bechtel Enka.
- Shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K. ,në kërkesën e saj ka sqarues se nga përfaqësuesit e kompanisë mbikëqyrëse të projektit të Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, janë informuar se ka





*ndryshuar traseja e autostradës dhe projekti është vendosur të realizohet jo me tunel siç ishte menduar më parë në fillim të realizimit të projektit por, pas matjeve dhe shpimeve në teren është vendosur që të realizohet përmes rrugës dhe hekurudhës ekzistuese dhe me ura ku pjesa më e madhe gjatë punimet të shtyllave dhe urave do të kalojë aty ku kalon edhe tubacioni për ndërtimin e Hidrocentralit HC Lepenci 1, dhe duke e parë se projekti i Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit është projekt Nacional i Qeverisë së Republikës së Kosovës jemi detyruar edhe përkundër fillimit të punimeve në trase ti ndërpresim punimet derisa të përfundohet pjesa e trases ku kalon tubacioni për ndërtimin e hidrocentralit HC Lepenci 1.*

- *Gjithashtu ka sqaruar, edhe pse nga përfaqësuesit e kompanisë mbikëqyrëse të projektit të Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, se ka ndryshuar traseja e autostradës dhe projekti është vendosur të realizohet jo me tunel siç ishte menduar më parë në fillim të realizimit të projektit por, pas matjeve dhe shpimeve në terren është vendosur që të realizohet përmes rrugës dhe hekurudhës ekzistuese me ura dhe shtylla të betonit, ku pjesa më e madhe gjatë punimeve të shtyllave dhe urave do të kalojnë aty ku ishte planifikuar të kalonte tubacioni në ndërtimin e Hidrocentralit HC Lepenci 1, dhe duke parë se projekti i Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit është projekt nacional i Qeverisë së Republikës së Kosovës, janë detyruar edhe përkundër fillimit të punimeve të trases ti ndërpresin punimet derisa të përfundohet pjesa e trasesë ku kalon tubacioni për ndërtimin e HC Lepenci 1, përderisa të përfundohen punimet në autostradë.*
- *Shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka sqaruar se gjatë gjithë kohës i është iu është drejtuar me shkrim kompanisë Bechtel Enka si ekzekutuese e projektit nacional Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezi, duke kërkuar sqarime se kur pritet të përfundohet traseja e autostradës, pasi që ne kemi menduar se në rast se definohet projekti i autostradës se nga do të kaloj, ne të bëjmë zgjidhje tjetër që mos të pengojmë projektin e tillë. Përfaqësuesit e Bechtel Enka asnjëherë nuk na janë përgjigjur derisa ndërrimi i autostradës ka arritur në pjesën ku prek edhe trasenë e tubacioneve të hidrocentralit Lepenci 1, dhe kanë vërtetuar se traseja e autostradës do të kaloj nëpër pjesën e trasesë ku pritet të vendosen tubacionet për projektin e hidrocentralit HC Lepenci 1.*
- *Nga kjo situatë fillimisht jemi detyruar të presin përgjigje nga Bechtel Enka dhe kanë ndaluar punimet, pasi që në të njëjtën pjesë të trasesë janë vendosur shtyllat gjigante për Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, kanë punuar makineri e rënd dhe derisa janë përfunduar punimet është dashur të pritet konfirmimi zyrtar nga kompania ekzekutuese e projektit të autostradës.*
- *Shoqëria “Hidorenergji” SH.P.K., poashtu sqaron se pas kërkesave të vazhdueshme në Kompaninë mbikëqyrëse të projektit të Autostradës Hill International nga Ministria e Infrastrukturës – Departamenti i Infrastrukturës Rrugore, zyrtarisht kanë pranuar konfirmimin për vazhdimin e projektit nr. 04 nr. prot. 9066 dt. 01.2017, me të cilën është konfirmuar se Ministria e Infrastrukturës është duke e implementuar projektin e ndërtimit Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, në bazë të të dhënave të projektit të dorëzuar nga ana e konzorciumit Bechtel Enka dhe të miratuar nga kompania Mbikëqyrëse Hill International, konstatohet se ruka ka konflikt në mes të projektit të autostradës me projektin e Hidroenergjisë për HC Lepenci 1, në lokacionin B 406.*
- *Ministria e Infrastrukturës ka Konfirmuar se: projekti i kompanisë “Hidroenergji” SH.P.K., ruka pengon realizimin e projektit të Ndërtimit të Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, dhe kompania “Hidorenergji” sh.p.k., mund të vazhdoj me realizimin e projektit në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese në Lumin Lepenc, HC Lepenci 1.*






- Gjithashtu në njoftimin zyrtar të Ministrisë është theksuar se gjatë implementimit të projektit duhet të koordinohen me përfaqësuesit e konzorciumit Bechtel Enka dhe kompaninë Mbikëqyrëse Hill International, për të cilën janë të gatshëm dhe do të bashkëpunojnë në realizimin të projekteve në fjalë, pa e penguar njëra tjetrën edhe përkundër faktit se pjesa e Autostradës B406 tani më pothuajse është para fazës finale dhe nuk do të paraqesë ndonjë problem eventual.
- Poashtu edhe kompania Mbikëqyrëse e projektit të Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit në dokumentin e dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës të datës 30.11.2017 ka theksuar se bazuar në kërkesën e kompanisë Hidroenergjii sh.p.k., të datës 14.11.2017 (prot. Nr. 8674), lidhur me ndërveprimet e punimeve për projektin e ndërtimit të Hidrocentralit HC Lepenci 1 me punimet e rruqës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, kanë sqaruar se në bazë të informatave të disponueshme të projektit të dorëzuar nga kompania Bechtel Enka, përmes lidhjeve nuk ka konflikt në mes të punëve të shtyllave P9 dhe P10 dhe urës B406 dhe shtrirjes së tubave të çelikut për projektin HC Lepenci 1.
- Prandaj edhe përkundër përgjigjeve të dhënura nga kompania mbikëqyrëse Hill International, dhe Ministria e infrastrukturës, se realizimi i projektit të firmës Hidroenergjii sh.p.k., nuk ka konflikt dhe nuk e pengon realizimin e projektit të Autostradës R8 Prishtinë – Hani i Elezit, në është dashur të presim përfundimin e asaj pjese ku preket edhe projekti HC Lepenci 1, pasi që makineria e kompanisë Bechtel Enka gjatë gjithë vitit 2018 ka punuar në atë pjesë dhe ka qenë shumë e vështirë të punohet nga kompania e jonë në hapjen e trasesë dhe shtrirjes së tubacionit, duke i pasur parasysh se mund të shkaktohet ndonjë fatkeqësi, dhe tani më sipas informatave pritet të finalizohet edhe ajo pjesë e autostradës dhe të krijohen kushtet për realizimin e projektit të Hidroenergjisë.
- Gjithashtu kanë informuar se me datë 18.01.2019 pran Kuvendit Komunal të Komunës së Kaçanikut dhe Drejtorisë për Urbanizëm – Inspektoratit, kanë bërë kërkesë me shkrim, që të iu lëshohet një vërtetim me të cilën vërtetohet se firma Hidroenergjii sh.p.k., për Hidrocentralin HC Lepenci 1 i ka filluar punimet në ndërtimin e këtij hidrocentrali sipas Lejes ndërtimore të lëshuar nga komuna e Kaçanikut.
- Nga Inspektorati i Komunës së Kaçanikut, me datë 18.01.2019, kanë pranuar njoftimin me shkrim 06 nr. 354/01-1742/19, me të cilën janë njoftuar se firma Hidroenergjii sh.p.k., pran DUKMM dhe Inspektoratit të ndërtimit, ka bërë kërkesë me shkrim për konfirmim të fillimit të punimeve në këtë hidrocentral. Pas vizitës nga Inspektorati i Ndërtimit të Komunës së Kaçanikut në vend-punishte me 18.01.2019, kanë vërtetuar fillimin e punimeve, në pastrimin e terrenit dhe krijimin e kushteve të punës në vend-punishte.
- Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha këto që u cekën më lartë shoqëria “Hidroenergjii” SH.P.K., ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që bazuar në dispozitat e nenit 16 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin kapaciteteve të reja gjeneruese në fuqi në datën e lëshimit të Autorizimit Final V\_754\_2016 për ndërtimin e Hidrocentralit HC Lepenci 1 me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, si projekt i rëndësishëm për prodhimin e energjisë nga Burimet e ripërtrishme të Energjisë, të iu lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final për ndërtimin e Hidrocentralit edhe për një (1) vit, pasi që vonesat janë shkaktuar nga realizimi i projektit Nacional të Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, e për të cilën besojnë dhe shpresojnë se shumë shpejt pritet të përfundohet Autostrada dhe të vazhdojnë me ndërtimin e këtij Hidrocentrali.



- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë “Hidroenergjia” SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lumin Lepenc HC Lepenci 1 me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, në Komunën e Hanit të Elezit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se kërkesa është e bazuar pasi që vonesat për mosrealizimin e këtij Hidrocentrali kanë ardhur si pasojë e ndërtimit të Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V\_754\_2016 i datës 28 janar 2016, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V\_754\_2016 i datës 28 janar 2016, do të vlen deri me datë **28 janar 2020**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, dhe në rast se nuk arrin të përfundojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Hanit të Elezit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së